



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 550, datë 29.7.2022

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.296,
DATË 19.5.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E FLAMURIT, STEMËS, UNIFORMËS
DHE NGJYRËS SË SHENJAVE NË MJETET E POLICISË
SË BURGJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 27, të ligjit nr.80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.296, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, fjalët “... në aneksin nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë ...” zëvendësohen me “... në anekset nr.2 dhe nr.2/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë ...”.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përbajtje:

“2/1. Normat e furnizimit me uniformë të punonjësve të Policisë së Burgjeve bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”.

3. Pika 2, e aneksit nr.1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me përbajtjen si vijon:

“2. Stemat e Policisë së Burgjeve:



Në krahun e djathtë të uniformës vendoset stema zyrtare e Policisë së Burgjeve/Forcat Operacionale dhe në krahun e majtë vendoset stema e Republikës me citimin Policia e Burgjeve.



Stema e Republikës Stema e Policisë së Burgjeve Stema
e Forcës Operacionale”

4. Në aneksin nr.2, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “e”, “ë” dhe “gj”, të pikës 2, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“e) Për stinën e dimrit uniforma përbëhet nga këmishë me mëngë të gjata me spaleta dhe xhepa ngjyrë bojëqielli, me kollare. Në krahun e majtë të këmishës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve. Këmisha vishet me pantallona dimërore stofi dhe funde stofi përfemrat me ngjyrë blu të errët. Kësaj uniforme i shtohet pardesy dhe kollare ngjyrë blu e errët.”.

“ë) Për stinën e dimrit vishet xupi sintetik me veshje të ngrohtë brenda me spaleta, ngjyrë blu e errët. Veshja e ngrohtë është me zinxhirë dhe kopsa, e çmontueshme sipas stinës. Këpucët përfkëtë janë me qafë, lëkure pa shkëlqim. Në krahun e majtë të xhupit vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së

Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve.”.

“gj) Kostumi në rastet ceremoniale vishet me këmishë me mëngë të gjata ngjyrë të bardhë. Këpucët janë gjysma, lëkure, të zeza dhe pa shkëlqim. Kapelja është e rrumbullakët. Kësaj uniforme i shtohet edhe kollare ngjyrë blu e errët që kapet me karficë dhe kordon dekorativ.”.

b) Shkronjat “ë”, “gj” dhe “j”, të pikës 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ë) Për stinën e dimrit vishet xupi sintetik me veshje të ngrohtë brenda me spaleta, ngjyrë blu e errët. Veshja e ngrohtë është me zinxhirë dhe kopsa, e çmontueshme sipas stinës. Këpucët për këtë stinë janë me qafë, lëkure pa shkëlqim. Në krahun e majtë të xhupit vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve.”.

“gj) Për rastet ceremoniale uniforma përbëhet nga uniforma e punës sipas stinës. Në krahun e majtë të xhaketës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve”.

“j) Punonjësit e rolit bazë në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm sipas stinës përfitojnë edhe pelerinë shiu, doreza lëkure, çorape, rrip mesi dhe rrip shumëfunksional.”.

c) Shkronjat “ë”, “f” dhe “g”, të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ë) Për stinën e dimrit uniforma përbëhet nga bluzë me jakë me tre komça ose jakë golf, me mëngë të gjata, ngjyrë blu e errët dhe bluzë me mëngë të gjata, jakë e rrumbullakët. Në krahun e majtë të bluzës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve. Bluzat vishen me pantallona dimërore dok të trashë, ngjyrë blu e errët. Këpucët janë me qafë (tip kombale), të zeza dhe pa shkëlqim.”.

“f) Për stinën e dimrit vishet xupi sintetik me veshje të ngrohtë brenda me spaleta, ngjyrë blu e errët. Veshja e ngrohtë të jetë me zinxhir dhe kopsa, e çmontueshme sipas stinës. Këpucët për këtë stinë janë me qafë, lëkure dhe pa shkëlqim. Në krahun e majtë të bluzës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve.”.

“g) Kjo kategori punonjësish sipas stinës përfitojnë jelek operacional, kominoshe, kostum stërvitjeje, veshje të brendshme, uniformë speciale kundër zjarrit, pelerinë shiu, doreza lëkure, çorape dhe rrip shumëfunksional.”.

5. Pas aneksit nr.2, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi nr.2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “*Eletoren zyrtare*”.

The image shows a handwritten signature in blue ink, reading "Edi Ramush", placed over a formal document header. The header includes the title "KRYEMINISTRI" above "EDI RAMA", the position "MINISTRI I DREJTËSISË" to the left, and "ULSI MANJA" below the signature. The signature is written in a cursive style and is partially obscured by a blue ink circle.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA
MINISTRI I DREJTËSISË
ULSI MANJA

NR.PROT.4389/1
DATË 2.8. 2022

MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI
